



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I MBROJTJES SË KONSUMATORËVE

VENDIM

Nr. 37, Datë 25.06.2015

Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorëve me pjesëmarrjen e:

- | | |
|------------------------|------------|
| - Znj. Klotilda Neziri | Kryetare |
| - Z. Zamir Stefani | Nënkryetar |
| - Znj. Ermonela Xhafa | Anëtare |
| - Z. Sokol Pasho | Anëtar |
| - Z. Zhani Shapo | Anëtar |

në mbledhjen e tij të datës 09.06.2015, mori në shqyrtim ankesën e konsumatorëve në lidhje me praktikën e ndjekur nga Shoqëria Ujësjiellës Kanalizimeve, Tiranë (UKT) nëpërmjet njoftimit të publikuar në faturën e ujit për detyrimin e verifikimit të aparatit matës nga konsumatorët.

Komisioni me ane të shkresës nr. prot. 32, datë 19.06.2015 ka njoftuar UKT, si dhe palët e interesuara Entin Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë (ERRU) dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë (DPM), për fillimin e procedurës së shqyrtimit të ankesës së sipërpërmendur dhe organizimin e një seance dëgjimore.

Komisioni pas shqyrtimit të materialeve përkatëse: ankesën e konsumatorëve, informacionin e DPM, njoftimin e konsumatorëve në faturën e ujit, si dhe dëgjimin e përfaqësuesve të UKT, ERRU dhe DPM në seancën dëgjimore të zhvilluar në mbledhjen e KMK në datë 25.06.2015,

VËREN SE:

Praktika e ndjekur nga UKT, ku nëpërmjet faturave të ujit ka bërë njoftimin e konsumatorëve për të kryer verifikimin e aparatit matës të konsumit të ujit *"...duke kontaktuar në mënyrë të drejtpërdrejtë me një nga subjektet e autorizuar nga DPM ose nëpërmjet UKT"*, është një praktike e padrejtë tregtare në kundërshtim me Ligjin nr. 9902, datë 17.4.2008 "Për mbrojtjen e konsumatorëve", i ndryshuar, pasi:

Informacioni që përmban njoftimi drejtuar konsumatorëve, referuar nenit 18 e në vijim të Ligjit nr.9875, datë 14/02/2008 "Për metrologjinë", nuk mban në konsiderate dhe nuk përmend detyrimin ligjor të subjektit tregtar për verifikimin e instrumentit matës, sipas nenit nr. 26, pika 3 të ligjit nr. 9875, date 14/02/2008 "Për metrologjinë"

"Verifikimi periodik i instrumenteve matëse, si matësit e ujit të ngrohtë dhe të ftohtë, matësit e energjisë elektrike dhe të gazit janë përgjegjësi ligjore e personave juridike apo fizike që shesin ujin e ftohtë apo të ngrohtë, gazin dhe energjinë elektrike",

Në këtë kuptim informacioni i dhënë konsumatorëve është i mangët dhe i pavërtetë, duke e bere praktiken tregtare, një praktike çorientuese për konsumatorët, referuar dispozitave të Ligjit nr. 9902, datë 17.4.2008 "Për mbrojtjen e konsumatorëve", i ndryshuar, si vijon:

Pikave 1, 4/a dhe 5 të Nenit 13:

1. Një praktikë tregtare është e padrejtë kur:

a) është në kundërshtim me kërkesat që një tregtar pritet, në mënyrë të arsyeshme, të zbatojë ndaj konsumatorëve, në përputhje me praktikën e tregtimit të ndershëm dhe/ose me parimin e përgjithshëm të mirëbesimit në fushën respektive të veprimtarisë tregtare;

4. Praktikën tregtare vlerësohen të padrejta, veçanërisht, kur:

a) janë çorientuese, sipas përcaktimit në nenet 14, 15 dhe 17 shkronja "A" të këtij ligji;

5. Praktikën e padrejtë tregtare janë të ndaluara.

Pikës 1 të nenit 14: "Një praktikë tregtare është çorientuese kur përmban informacion të rremë dhe për rrjedhojë është e pavërtetë."

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni mbështetur në nenet 13, 14, 52, dhe nenin 55 të Ligjit nr. 9902, dt. 17.04.2008 "Për mbrojtjen e konsumatorëve", i ndryshuar, si dhe në pikat 2/e; 6 dhe 31 të VKM nr. 1444, datë 22.10.2008 "Për mënyrën e funksionimit e të pagesës së anëtarëve të komisionit të mbrojtjes së konsumatorëve, si dhe përcaktimin e procedurave të vlerësimit të shkeljeve",

VENDOSI:

1. Shoqëria Ujësjiellës Kanalizime, Tiranë (UKT), të ndalojë menjëherë shkeljen.
2. UKT të marrë të gjitha masat për ndreqjen e shkeljes, përfshirë këtu njoftimin për e konsumatorëve për procedurat e verifikimit të aparateve matës, në mënyrë individuale nëpërmjet faturave, si dhe publike (media, faqen zyrtare të internetit, etj.).
3. UKT të marrë të gjitha masat për mos përsëritjen e praktikave të tilla;
4. UKT të njoftojë Komisionin e Mbrojtjes së Konsumatorëve për zbatimin e pikës 2, të këtij vendimi, brenda 30 ditësh nga marrja e njoftimit të këtij Vendimi.
5. Publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.

Kundër Vendimit të Komisionit të Mbrojtjes së Konsumatorit, në baze të pikës 1 të nenit 59 të Ligjit 9902/2008, i ndryshuar mund të bëhet ankim në Gjykatë brenda 30 ditëve nga data e marrjes dijeni për vendimin.

KRYETAR I KOMISIONIT

KLOTHIDA NEZIRI

